



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 18.4.2023

Nr: 373

Ora: 10:00

VENDIM

PËR

DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJES SË QV NR.1796, QV NR.1796/01, QV NR.1796/02, BASHKIA TIRANË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 62, pika 4, nenin 93, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja, sipas përcaktimit të nenit 62, pika 4, të Kodit Zgjedhor.

Në KQZ është administruar propozimi i Administratorit, të autorizuar nga kryetari i bashkisë Tiranë, të njësisë administrative nr. 4, për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjeve të 3 (tre) qendrave të votimit, konkretisht të QV nr. 1796, QV nr. 1796/01 dhe QV nr. 1796/02, nga ambient privat të z. Robert Bano, në ambient privat të z. Kastriot Isufaj, me arsyetimin që ambienti i z. Robert Bano nuk plotëson kushtet dhe kriteret e ligjit për të shërbyer për qendër votimi.

Ambienti privat i z. Kastriot isufaj ka shërbyer si qendër votimi edhe në zgjedhjet e kaluara.

Nga verifikimi i kryer në terren nga administrata e KQZ-së, rezulton e njëjta situatë sikundër referohet nga Administratori i njësisë administrative, ambienti i z. Roberto Bano nuk ka kushte

Data: 18.4.2023 Nr: 373
Ora: 10:00



“Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 1796, QV nr. 1796/01, QV nr. 1796/02, Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

për të shërbyer si qendër votimi (mungesë instalimesh të energjisë elektrike, thuajse në fazë karabina).

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 62, pika 4, nenin 93, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S :

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 1796, QV nr. 1796/01, QV nr. 1796/02, duke i caktuar në ndërtesën private, ambient shërbimi, të z. Kastriot Isufaj.
2. Administratori i njësisë administrative të afishojë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, të caktuara me këtë vendim.
3. Administratori i njësisë administrative të rinjoftojë menjëherë zgjedhësit, për adresën e re të qendrave të votimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror i Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI